



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.367/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.367/2025, e datës 04.02.2025 e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.367/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog, ka identifikuar pjesëmarrjen e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, në tubimin e mbajtur të datës 02 shkurt 2025 të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në Vrellë të Istogut. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se subjekti politik LDK, me qëllim të përfitimit të votave lejon pjesëmarrjen edhe të fëmijëve në takim e cila është mbajtur në orët e vona të mbrëmjes (21:30) dhe më këtë subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve,

Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Sipas parashtruesit të ankesës përmes këtij veprimi subjekti përkatës, ka cënuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore, andaj duke mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP-së, mes tjerash me vendimin A.nr.212/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Parashtruesi i ankesës si provë, ka bashkangjitur fotografi dhe linkun ku dëshmohet pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore <https://www.facebook.com/reel/934671605534422>.

Më datë 05.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 05.02.2025, deri në ora 18:30.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se si provë ka bashkangjitur një pëlqim me mbishkrim të prindërve të fëmijës nën moshën 15 vjeçare, me tekstin “Unë [redacted] [redacted] deklaroj se me datën 26.02.2025 rreth orës 21 kam qenë në fushatën elektorale në fshatin Vrellë së bashku me djalin tim [redacted] dhe me bashkëshortin tim” dhe në foto vërehen letërnjoftimet dhe nënshkrimet e dy bashkëshortëve të këtij mbishkrimi, po ashtu si provë ka bashkangjitur Çertifikatën e lindjes së djalit të tyre.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar neni 5 paragrafi 3 parasheh se “Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.”, me arsyetimin se bazuar në përgjigjen në ankesën Anr.367/2025 rezultoi se personi në fjalë është 15 vjeçar dhe i njëjti ka qenë në shoqërinë e prindërve të tij në tubimin e mbajtur, fakt ky që e argumentojnë edhe provat e bashkangjitura si çertifikata e lindjes i cili shihet se ka lindur në vitin 2011 dhe pëlqimi i bashkangjitur si provë nga ana e prindërve të fëmijës.

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara

në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.367/2025 datë 07.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.